



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY

|                               |  |
|-------------------------------|--|
| <b>DATË/A:</b>                | 28/10/2015   |
| <b>REFERENC-Ë:</b>            | AKK – DPK - DPKPP – 03-03/3668/15; 03-03/3669/15; 03-03/3670/15; 03-03/3671/15                                   |
| <b>PËR/ZA/TO:</b>             | z. Maja POPOVIQ<br>Menaxhere e Prokurimit - Komuna Zveçan  |
| <b>CC:</b>                    | z. Vuçina JANKOVIQ<br>Kryetar Komune – Komuna Zveçan   |
| <b>NGA/OD/FROM:</b>           | Hasan PRETENI,<br>Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit  |
| <b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b> | Opinion lidhur me tenderin: “Ndërtimi i urave në lagjen Duriqi, Jaha si dhe ndërtimi i murit mbrojtës në Metehi” |

E nderuara znj. POPOVIQ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderët: “Ndërtimi i 10 shtëpive për banim social” me numër prokurimi:646-16026/15/014/521; “Ndërtimi i 2 ndërtesave banimi për banim social” me numër prokurimi:646-16026/15/026/521 ; “Kryerja e shërbimeve organit mbikëqyrës – menaxher i projektit për nevojat e Komunës së Zveçanit” me numër prokurimi: 646-16026/15/020/221 ; “Blerja e pajisjeve mjekësore për nevojat e Qendrës së Mjekësisë Familjare “Zveçan” në Zveçan” me numër prokurimi: 646-16026/15/008/121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

**OPINION**

Në lidhje me Tenderët e lartpërmendur, në mënyrë që aktivitetet e prokurimit edhe në këtë komunë të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042.

## A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Zveçanit, bazuar në nevojat e saja për të realizuar punë dhe furnizime ka paraparë disa aktivitete prokurimi me Procedurë të hapur, të cilat janë publikuar në KRPP në muajin tetor.

Agjencia kundër Korrupsion ka identifikuar se Komuna e Zveçanit, si Autoritet Kontraktues gjatë përpilimit të dosjeve të tenderit nuk ka dhënë vëmendjen e duhur, ku edhe janë bërë disa shkelje që bien ndesh me legjislacionin e Prokurimit Publik.

Në "Njoftim për Kontratë" të aktiviteteve: "Ndërtimi i 10 shtëpive për banim social"; "Ndërtimi i 2 ndërtesave banimi për banim social"; "Kryerja e shërbimeve organit mbikëqyrës – menaxher i projektit për nevojat e Komunës së Zveçanit"; dhe "Blerja e pajisjeve mjekësore për nevojat e Qendrës së Mjekësisë Familjare "Zveçan" në Zveçan", tek pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që: "Operoret ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi se ka realizuar me sukses shërbimet e njëjtë ose të ngjashme në tri vitet e fundit, të paktën 3, dhe gjithashtu ka përvojë në punë me Komunitat në veri të Kosovës". Përcaktimi i përvojës së punës vetëm në Komunitat e Veriut të Kosovës është kriter diskriminues. Si i tillë favorizon një numër të Operatorësh Ekonomik të cilët kanë realizuar punë në komunitat e cekura dhe në të njëjtën kohë diskriminon ata të cilët nuk kanë realizuar punë në ato komunitat. Ky formulim po ashtu nuk i lehtësuar të mjaftueshme ekonomisë së lirë të tregut.

Pra, Autoriteti Kontraktues duhet të sigurohet që të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk do të ekzekutojë asnjë aktivitet të prokurimit në një mënyrë që minimizon apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë që bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik.

Agjencia Kundër Korrupsion i rekomandon Autoritetit Kontraktues që të marr hapat e nevojshëm për evitimin shkeljeve të lartë cekura dhe të veproj në pajtim me ligjin e Prokurimit gjatë vazhdimit të aktivitetit në fjalë.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !